



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Mandate, Imunitete e Rregullore të Punës të Kuvendit  
Mbledhja nr. 20  
Prishtinë, më 26. 01. 2010, ora 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

**P r o c e s v e r b a l**

**I mbledhjes së Komisionit për Mandate, Imunitete e Rregullore të Punës të Kuvendit**

Në mbledhje morën pjesë: Hydajet Hyseni - Kaloshi, Kolë Berisha, Dzezair Murati, Ramadan Gashi, Fatmire Berisha, Ahmet Isufi dhe Radmila Vujovic.

Munguan: Suzan Novobrdaliu dhe Besa Gaxherri.

Pjesëmarrës të tjerë: Floriana Shala e Blerim Vela - OSBE, Rrezarta Ahmeti - KDI, Shefki Kastrati e Rinor Beka - NDI.

Të pranishëm nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Hydajet Hyseni - Kaloshi - kryetar i Komisionit.

**R E N D I I D I T Ë S**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 15 janarit 2010;**
- 3. Shqyrtimi i Planit të veprimit të Kuvendit për integritet evropian;**
- 4. Miratimi i Planit dhe i Programit të punës së Komisionit;**
- 5. Të ndryshme.**

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

*Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua njëzëri.*

## 3. Shqyrtimi i Planit të veprimit të Kuvendit për integritet evropiane

**Hydajet Hyseni** - Lidhur me Planin e veprimit për integritet evropiane tha se Kuvendi e ka vlerësuar si përparësi dhe është në proces të përpunimit dhe të zbatimit të tij. Plani i veprimit për integritet evropiane është kërkuar të shqyrtohet nga secili komision nga aspekti i fushëveprimit të vet. Komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore është angazhuar në këtë drejtim. Në Projektregullore i ka përfshirë drejtpërdrejt disa nga parashikimet e Raportit të Progresit. Kjo mund të konsiderohet punë e suksesshme. Megjithatë Komisioni do t'i shqyrtojë edhe disa çështje të tjera, të cilat do të mund të inkorporoheshin në Planin e veprimit për integritet evropiane.

**Blerim Vela** - OSBE - Tha se Komisioni me vetinkorporimin e ndryshimeve në Projektregullore e ka përmbushur detyrimin e tij, që do ta mundësonte zbatimin më të lehtë të Planit të veprimit për integritet evropiane. Lidhur me shqyrtimin e praktikave të mbikëqyrjes parlamentare mbi degën e ekzekutivit tha se Komisioni nuk ka ndonjë detyrim.

*Komisioni pas shqyrtimit të Planit të veprimit për integritet evropiane e nxori këtë*

### ***P ë r f u n d i m***

*Komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës të Kuvendit e përkrah miratimin e Planit të veprimit për integritet evropiane të Kuvendit të Republikës së Kosovës.*

## 3. Miratimi i Planit dhe i Programit të punës të Komisionit

**Hydajet Hyseni** - Tha se në Draftplanin dhe në Programin e Komisionit për vitin 2010, në objektivat e Komisionit, duhet të jetë përcaktimi i fushëveprimit të Komisionit. Lidhur me Planin e punës të Komisionit tha se pas përfundimit të punës me Rregulloren, Komisioni do të punojë në projektligje, aty ku ka mundësi dhe në shtojcat e Rregullores. Për këtë propozoi që në Planin e punës, Komisioni ta parashohë formimin e grupeve të punës, duke filluar nga shkurti, për fjalorin parlamentar, për mandate e imunitete, për strukturimin e komisioneve dhe për konflikt interesi.

Shqyrtimi i praktikave të mbikëqyrjes parlamentare mbi degën e ekzekutivit, tha se nuk është kompetencë e Komisionit dhe duhet të zëvendësohet me detyrime të tjera.

**Ahmet Isufi** - Mendon se Komisioni duhet ta formojë vetëm një grup pune, i cili në mënyrë periodike do të merrej me çështjet e përcaktuara në Planin e punës.

*Komisioni, pas shqyrtimit të Draftplanit dhe të Programit të punës për vitin 2010, e nxori këtë*

### ***P ë r f u n d i m***

*Njëzëri miratohen, në parim, Plani dhe Programi i punës të Komisionit për vitin 2010, me plotësimet e propozuara.*

#### **4. Të ndryshme**

**Kolë Berisha** - Propozoi që Komisioni në të ardhmen ta përcaktojë rendin e ditës për mbledhjen e ardhshme të Komisionit.

**Hydajet Hyseni** – Për Projektregulloren e Kuvendit tha se me amendamentet plotësuese u është shpërndarë anëtarëve të Komisionit dhe mund të procedohet për miratim në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E hartoi:

Njësia për mbështetje të Komisionit.

Kryetari i Komisionit

---

Hydajet Hyseni -Kaloshi